



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI I LËNDES SË INTEGRUAR: NDËRMARRËSIA E GJELBER

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Ndërmarrësia e Gjellbër
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Semestri pranveror
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Fisnik Morina Ph.D. (cand). Besfort Ahmeti
Detajet kontaktuese:	fnik.morina@unhz.eu besfort.ahmeti@unhz.eu
Përshkrimi i lëndës	Ndërmarrësia e Gjellbër është një kurs ndërdisiplinor që synon të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi për të zhvilluar dhe menaxhuar iniciativa të qëndrueshme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Kjo lëndë eksploron lidhjen midis ndërmarrësisë, inovacionit dhe qëndrueshmërisë, duke i dhënë studentëve mundësinë të kuptojnë sesi bizneset mund të krijojnë vlerë ekonomike duke respektuar kufijtë ekologjikë dhe duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies sociale.
Qëllimet e lëndës:	1. Të kuptojnë konceptet themelore të ndërmarrësisë së gjellbër dhe ndikimin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm, duke lidhur teorinë me praktikën e sektorëve specifikë. 2. Të analizojnë sfidat dhe mundësitë e ndërmarrësisë së gjellbër në kontekste të ndryshme si biznesi, turizmi, mjedisi, agrobiznesi, juridiku, informatika në biznes, menaxhimi i riskut, sigurimet dhe menaxhimi i burimeve njerëzore. 3. Të vlerësojnë ndikimin e politikave dhe

	legjislacionit mjedisor në krijimin dhe menaxhimin e bizneseve të qëndrueshme në fusha të ndryshme. 4. Të identifikojnë dhe zhvillojnë modele biznesi të qëndrueshme, duke përfshirë ekonomi qarkore, inovacione teknologjike dhe strategji për reduktimin e ndikimit mjedisor. 5. Të aplikojnë metoda të analizës financiare dhe të menaxhimit të riskut për të vlerësuar qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të ndërmarrjeve të gjelbra. 6. Të zhvillojnë strategji për promovimin e turizmit të qëndrueshëm, agrobiznesit të gjelbër dhe aplikimin e teknologjisë së informacionit në bizneset e gjelbra. 7. Të integrojnë parimet e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe etikës mjedisore për të krijuar një kulturë organizative që mbështet sipërmarrjen e gjelbër. 8. Të krijojnë plane biznesi inovative që reflektojnë konceptet e ndërmarrësisë së gjelbër, duke përfshirë strategji për financim të qëndrueshëm dhe investime mjedisore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti duhet të jenë në gjendje të: 1. Shpjegon rëndësinë e ndërmarrësisë së gjelbër dhe ndikimin e saj në zhvillimin e qëndrueshëm në fusha të ndryshme të menaxhimit. 2. Analizon politikat ndërkombëtare dhe ligjore që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe bizneset e gjelbra, duke u fokusuar në normat e BE-së dhe të Kosovës. 3. Diskuton burimet e financimit dhe mundësitë e investimeve për bizneset e gjelbra, duke përfshirë obligacionet e gjelbra dhe platforma crowdfunding. 4. Eksploron teknologjitë dhe inovacionet që mundësojnë zhvillimin e ndërmarrësisë së gjelbër, duke përfshirë inteligjencën artificiale dhe blockchain. 5. Vlerëson mundësitë e menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit si pjesë të strategjive

	të biznesit të gjelbër, duke u fokusuar në reduktimin dhe përpunimin e mbetjeve. 6. Diskuton ndikimin social të ndërmarrësisë së gjelbër në zhvillimin e komunitetit dhe përfshirjen sociale, si dhe strategjitë e përgjegjësisë sociale. 7. Përshkruan përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të biznesit të gjelbër dhe rëndësinë e certifikimeve dhe auditimeve për raportimin e qëndrueshmërisë. 8. Diskuton rëndësinë e edimit dhe aftësimi për ndërmarrësit e gjelbër dhe rolin e institucioneve arsimore në zhvillimin e aftësive menaxheriale për bizneset e qëndrueshme. 9. Analizon strategjitë e marketingut për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të gjelbra dhe ndikimin e mediave sociale dhe marketingut digjital. 10. Zhvillon një plan biznesi për ndërmarrësinë e gjelbër, duke u fokusuar në identifikimin e tregut, financimin dhe strategjitë operacionale që mbështesin qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të gjelbër.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime praktike në teren	1	10	10
Seminare, projekte, prezentimet, etj.	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim	10	1	10

(teste, kuiz, provim final)			
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Në këtë lëndë, përdoren metoda të ndryshme mësimdhënës për të siguruar një mësim aktiv dhe të integruar, duke stimuluar përfshirjen e studentëve dhe zhvillimin e aftësive praktike dhe analitike. Metodologjia e mësimdhënies përfshin: Ligjeratat : - o Ligjeratat ofrojnë një pasqyrë të thelluar të teorive dhe koncepteve kryesore të ndërmarrësisë së gjelbër, duke përfshirë menaxhimin e riskut, përdorimin e teknologjive të qëndrueshme, implementimin e praktikave të biznesit të gjelbër, zhvillimin e strategjive për përshtatjen e bizneseve në tregjet globale, si dhe analizën e mundësive dhe sfidave që paraqiten në krijimin dhe menaxhimin e modeleve të qëndrueshme të biznesit. Kjo strukturë do të mundësojë studentëve të kuptojnë thelbin e ndërmarrësisë së gjelbër dhe t'i pajisë ata me njohuri të avancuara për të aplikuar këto parime në praktikën e menaxhimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. - o Këtu përfshihen gjithashtu diskutohet dhe analizohen aspekte të ndryshme teorike të menaxhimit të qëndrueshëm, si dhe teknikat për matjen e performancës së qëndrueshme dhe ndikimin e politikave mjedisore në biznes. - o Gjatë ligjëratave do të ofrohen dhe raste studimi, ku studentët analizojnë kompani që kanë implementuar strategji të qëndrueshme dhe ndërmarrësi të gjelbra, për të aplikuar njohuritë teorike në situata reale. Ushtrimet: - o Ushtrimet do të përqendrohen në zhvillimin e një plani biznesi të gjelbër. Grupi i studentëve (3-5 studentë) do të punojnë së bashku për të krijuar		

	një plan biznesi që përfshin aspekte të menaxhimit të rreziqeve, zbatimin e praktikave qëndrueshmërie dhe përdorimin e teknologjive të gjelbërta në një biznes. ○ Ky plan biznesi do të vlerësohet me 50% të notës përfundimtare të lëndës. Puna në grupe do të inkurajojë bashkëpunimin dhe do të ndihmojë studentët të zhvillojnë aftësi praktike në aplikimin e teorive dhe metodave të mësuara. Plani i Biznesit të Gjelbër (Grupet 3-5 studentë): ○ Grupi do të zhvillojë një plan të detajuar biznesi të gjelbër, ku do të përfshihen aspekte të tilla si analiza e tregut, strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm, përdorimi i burimeve dhe risqet mjedisore. Ky plan do të jetë i detajuar dhe do të paraqesë një model biznesi që është në përputhje me praktikën e qëndrueshmërisë. ○ Ky aktivitet është një mundësi për studentët që të aplikojnë njohuritë teorike në një projekt praktik dhe të zhvillojnë aftësi analitike dhe strategjike. Rastet e Studimit: ○ Pjesë e rëndësishme e ligjeratave janë raste studimi, ku studentët analizojnë dhe diskutojnë kompani që kanë pasur sukses në implementimin e strategjive të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të gjelbër. ○ Këto raste do t'u mundësojnë studentëve të aplikojnë njohuritë teorike dhe t'u japin mundësinë të diskutoni për sfidat dhe mundësitë që paraqiten në implementimin e këtyre strategjive në një mjedis të biznesit të gjelbër. Diskutimet: ○ Diskutimet e udhëhequra nga mësimdhënësi dhe studentët janë të rëndësishme për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe analitik. Ato do të përqendrohen në analizimin e literaturës së shpërndarë, rasteve studimi dhe çështjeve të ndryshme të qëndrueshmërisë dhe menaxhimit të riskut në biznesin e gjelbër. ○ Pjesëmarrja aktive në diskutime është e rëndësishme dhe do të vlerësohet me 10% të notës përfundimtare. Diskutimet do të
--	---

	ndihmojnë studentët të mendojnë kritikunisht dhe të ndajnë idetë dhe mendimet e tyre në lidhje me praktikën dhe sfidat që lidhen me ndërmarrësinë e gjelbër. Konsultimet: ○ Studentët do të kenë mundësinë të zhvillojnë konsultime individuale për çështje që lidhen me materialet mësimore, detyrat dhe projektet e planit të biznesit të gjelbër. ○ Konsultimet do të sigurojnë mbështetje për zhvillimin e aftësive praktike dhe për realizimin e projekteve dhe planeve të biznesit të gjelbër. Aktivitetet tjera: ○ Aktivitetet praktike, si seminare dhe workshope, do të përfshijnë hulumtime të detajuara mbi mundësitë e biznesit të gjelbër dhe angazhimin e studentëve me kompani lokale për të zbatuar strategji të qëndrueshme. ○ Aktivitetet do të ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësi të mendimit kritik dhe bashkëpunimit në grupe dhe të zgjidhin probleme reale të bizneseve të gjelbra.
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 - 20% • Testi i dytë vlerësues: 0 - 20% • Plani i Biznesit (3-5 studentë): 0 - 50% • Interaktiviteti: 0 -10% • Provimi përfundimtar: 0 - 40%
Literatura	
Literatura bazë:	▪ <i>Ligjerta të përgaditura nga mësimdhënësi i lëndës</i> ▪ <i>Veland Ramadani (2024) – Ndërmarrësia e Qëndrueshme, Universiteti i Evropës Juglindore.</i> ▪ <i>Veland Ramadani, Robert D. Hisrich, Nora Sadiku – Dushi, Shqipe Gërguri – Rashiti (2022) – Ndërmarrësia dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogël, Universiteti i Evropës Juglindore.</i> ▪ <i>Geoffrey Jones (2017) – Fitimet dhe Qëndrueshmëria - Një histori e ndërmarrësisë së gjelbër, Universiteti i Oksfordit, 2017.</i>
Literatura shtesë:	▪ <i>Luca Berchicci (2009) - Innovating for Sustainability - Green entrepreneurship in personal mobility. Routledge studies in</i>

	innovation, organization and technology ▪ Riadh Habash (2017) - Green Engineering: Innovation, Entrepreneurship and Design. CRC Press; ROUTLEDGE.
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit) ○ Koncepti dhe rëndësia e ndërmarrësisë së gjelbër ○ Objektivat dhe përmbajtja e kursit ○ Metodologjia e ligjëratave dhe format e vlerësimit ○ Roli i ndërmarrësisë së gjelbër në zhvillimin e qëndrueshëm ○ Integrimi i fushave të ndryshme akademike në këtë kurs ○ Tendencat globale në biznesin e gjelbër ○ Përfitimet ekonomike dhe sociale të ndërmarrësisë së gjelbër ○ Liderhipi dhe menaxhimi i qëndrueshëm ○ Hyrje në modelet e biznesit të gjelbër ○ Rëndësia e inovacionit dhe teknologjisë në bizneset e gjelbra
Java e dytë:	Politikat në ndërmarrësinë e gjelber ○ Rregulloret dhe politikat ndërkombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm ○ Kuadri ligjor për bizneset e gjelbërta në Kosovë dhe BE ○ Politikat e fiskalitetit dhe incentivat për bizneset e gjelbërta ○ Certifikimet dhe standardet mjedisore ○ Përputhshmëria me politikat e BE-së për ekonominë e gjelbër ○ Ndikimi i politikave publike në inovacionin e gjelbër ○ Roli i institucioneve financiare në mbështetjen e ndërmarrjeve të gjelbërta ○ Politikat për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm ○ Menaxhimi i burimeve natyrore për zhvillimin e qëndrueshëm ○ Strategjitë e menaxhimit të riskut mjedisor për bizneset e gjelbërta

Java e tretë:	Financimi dhe investimet në ndërmarrësinë e gjelber 1. Burimet tradicionale dhe alternative të financimit për bizneset e gjelbërta 2. Grantet dhe skemat e subvencionimit për inovacionin e qëndrueshëm 3. Investimet e kapitalit të sipërmarrjes në bizneset e gjelbra 4. Obligacionet e gjelbra dhe tregjet e kapitalit 5. Roli i bankave në mbështetjen e ndërmarrësisë së gjelbër 6. Modelet e financimit të turizmit të qëndrueshëm 7. Kreditimi dhe risku financiar në ndërmarrësinë e gjelbër 8. Platforma crowdfunding për bizneset e qëndrueshme 9. Analiza kosto-përfitim për investimet në projekte të gjelbra 10. Praktikant më të mira ndërkombëtare për financimin e biznesit të gjelbër
Java e katërt:	Inovacioni dhe teknologjia në ndërmarrësinë e gjelbert 1. Rëndësia e inovacionit në zhvillimin e ndërmarrjeve të gjelbërta 2. Teknologjitë e reja dhe roli i tyre në ndërmarrësinë e qëndrueshme 3. Inteligjenca artificiale dhe digjitalizimi në menaxhimin e burimeve 4. Përdorimi i blockchain për transparencë në bizneset e gjelbërta 5. Eficienca energjetike dhe inovacionet në energjinë e ripërtëritshme 6. Inovacionet në menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin 7. Roli i teknologjisë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm 8. Aplikimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave në ndërmarrësinë e gjelbër 9. Modelet e suksesshme të biznesit të bazuara në inovacion të gjelbër 10. Roli i institucioneve akademike në zhvillimin e teknologjive të gjelbra.
Java e pestë:	Menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi në ndërmarrësinë e

	gjelbër - o Metodat dhe praktikat e menaxhimit të mbeturinave - o Riciklimi si mundësi biznesi në ekonominë e gjelbër - o Politikat dhe rregulloret mbi menaxhimin e mbeturinave - o Strategjitë e reduktimit të mbeturinave në prodhim - o Përpunimi i mbetjeve organike dhe prodhimi i biokompostit - o Menaxhimi i mbeturinave plastike dhe alternativa eko-miqësore - o Riciklimi në industrinë e ndërtimit dhe materialet e qëndrueshme - o Menaxhimi i mbeturinave në turizmin e qëndrueshëm - o Praktikë ndërkombëtare të menaxhimit të mbeturinave - o Edukimi dhe ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e riciklimit
Java e gjashtë:	Ndikimi social në ndërmarrësinë e gjelbër - o Roli i biznesit në përgjegjësinë sociale - o Ndikimi i ndërmarrësisë së gjelbër në zhvillimin e komuniteteve - o Punësimi dhe përfshirja sociale në bizneset e qëndrueshme - o Ndikimi i ndërmarrësisë së gjelbër në përmirësimin e cilësisë së jetës - o Modelet e biznesit me ndikim social pozitiv - o Roli i organizatave joqeveritare në promovimin e biznesit të gjelbër - o Strategjitë për ritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore - o Përfshirja e komunitetit në projektet e ndërmarrësisë së gjelbër - o Eko-etika dhe përgjegjësia korporative në menaxhimin e bizneseve - o Raste studimi për ndikimin social të ndërmarrjeve të gjelbërta.
Java e shtatë:	Përputhshmëria me standartet ndërkombëtare të ndërmarrësisë së gjelbër o Standardet ISO për mjedisin dhe qëndrueshmërinë

	○ Çertifikatat e gjelbërta për produktet dhe shërbimet ○ Përputhshmëria me rregulloret e BE-së për bizneset e gjelbërta ○ Auditimi mjedisor dhe standardet për raportimin e qëndrueshëm ○ Roli i institucioneve financiare në monitorimin e përputhshmërisë ○ Sistemet e vlerësimit të ndikimit mjedisor ○ Përgjegjësia ligjore e bizneseve për shkeljen e standardeve të gjelbërta ○ Çertifikimi në turizmin e qëndrueshëm dhe bujqësinë organike ○ Teknologjitë për monitorimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare ○ Rastet më të mira të përputhshmërisë me standardet globale
Java e tetë:	Testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Edukimi dhe përgatitja në ndërmarrësinë e gjelbër ○ Rëndësia e edukimit dhe aftësimit për ndërmarrësit e gjelbër ○ Programet arsimore dhe trajnimi për bizneset e gjelbërta ○ Aftësitë menaxheriale dhe teknike për ndërmarrjet e gjelbërta ○ Roli i universiteteve dhe institucioneve arsimore në edukimin e ndërmarrësisë së gjelbër ○ Partneritetet mes akademisë dhe sektorit privat për ndërmarrësinë e gjelbër ○ Edukimi për menaxhimin e riskut dhe sigurimet në bizneset e gjelbërta ○ Teknologjitë dixhitale dhe ndikimi i tyre në edukimin për ndërmarrësinë e gjelbër ○ Studime rastesh mbi edukimin e sipërmarrësisë së gjelbër ○ Strategji efektive për edukimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në ndërmarrjet e gjelbërta ○ Politikat dhe incentivat shtetërore për edukimin e sipërmarrësisë së gjelbër
Java e dhjetë	Marketingu i ndërmarrësisë së gjelbër ○ Strategjitë e marketingut për produktet dhe shërbimet e gjelbërta

	○ Brendi dhe pozicionimi i bizneseve të gjelbërta ○ Roli i mediave sociale dhe marketingut digjital në ndërmarrësinë e gjelbër ○ Strategjitë e komunikimit dhe fushatat e sensibilizimit ○ Marketingu etik dhe ndikimi i tij në konsumatorët ekologjikë ○ Zhvillimi i modeleve të biznesit që promovojnë qëndrueshmërinë ○ Studime rastesh mbi suksesin e kompanive që praktikojnë marketingun e gjelbër ○ Analiza e sjelljes së konsumatorëve dhe prirjeve të tregut për produktet e gjelbërta ○ Çertifikatat ekologjike dhe ndikimi i tyre në marketing ○ Strategji për promovimin e turizmit të gjelbër
Java e njëmbëdhjetë:	Hartimi i planit të biznesit për ndërmarrësinë e gjelbër ○ Hyrje në Planin e Biznesit për Ndërmarrësinë e Gjelbër – Rëndësia dhe veçoritë specifike të një plani biznesi të gjelbër. ○ Analiza e Tregut për Bizneset e Gjelbra – Identifikimi i tregut të synuar, trendeve dhe kërkesës për produkte/shërbime të qëndrueshme. ○ Përcaktimi i Vlerës së Propozimit (Value Proposition) – Si të krijoni një ofertë të dallueshme dhe me ndikim ekologjik. ○ Modeli i Biznesit për Ndërmarrësinë e Gjelbër – Përdorimi i metodave si Business Model Canvas për të strukturuar komponentët e biznesit të qëndrueshëm. ○ Strategjitë e Marketingut për Produktet/Shërbimet e Gjelbra – Kanale të komunikimit, brendi ekologjik dhe ndikimi në konsumatorët e përgjegjshëm. ○ Aspektet Ligjore dhe Regullatorët për Bizneset e Gjelbra – Licencat, standardet mjedisore dhe përputhshmëria me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. ○ Strategjitë e Financimit për Ndërmarrësinë e Gjelbër – Burimet e financimit si grantet, investimet e qëndrueshme dhe kreditë për bizneset e gjelbërta. ○ Menaxhimi i Burimeve dhe Efikasiteti Operacional – Roli i energjisë së rinovueshme, reduktimi i mbetjeve dhe optimizimi i proceseve për qëndrueshmëri më të madhe.

	○ Vlerësimi i Rrezikut dhe Strategjitë për Menaxhimin e Tij – Identifikimi i sfidave të mundshme dhe zhvillimi i një plani për t'i adresuar ato. ○ Mekanizmat e Matjes së Performancës dhe Ndikimit Mjedisor – Përdorimi i indikatorëve si ESG (Environmental, Social, Governance) dhe raportimi i qëndrueshmërisë.
Java e dymbëdhjetë :	Ndërmarrja dhe zhvillimi i hulumtimit shkencor në ekonominë e gjelbër ○ Roli i hulumtimit shkencor në zhvillimin e ekonomisë së gjelbër ○ Partneritetet akademike dhe industrisë për inovacionin e gjelbër ○ Hulumtimet mbi ndikimin ekonomik të teknologjive të qëndrueshme ○ Zbatimi i metodave të qëndrueshme në prodhim dhe konsum ○ Teknologjitë e reja për uljen e ndotjes dhe përdorimin efikas të burimeve ○ Studime mbi ndikimin e politikave ekonomike në bizneset e gjelbërta ○ Modelet e biznesit që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm ○ Roli i analizës së dhenave në hulumtimin mbi ekonominë e gjelbër ○ Sfidat dhe mundësitë e financimit të projekteve të hulumtimit mbi bizneset e gjelbërta ○ Zhvillimi i politikave kombëtare për ekonominë e gjelbër
Java e trembedhjetë:	Sfidat e brendshme dhe të jashtme në ndërmarrësinë e gjelbër ○ Sfidat ekonomike në zhvillimin e ndërmarrjeve të gjelbërta ○ Ndikimi i politikave shtetërore në ndërmarrësinë e gjelbër ○ Sfidat teknologjike dhe inovative në bizneset e qëndrueshme ○ Përshtatja me standardet dhe rregulloret mjedisore ○ Problematikat e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit në industrinë e gjelbër ○ Ndikimi i krizave ekonomike dhe politike në bizneset e gjelbërta ○ Sfidat në sigurimin e burimeve financiare për

	<i>zgjerimin e ndërmarrjeve të gjelbërta</i> ○ <i>Përshtatja me tregjet në ndryshim dhe konkurrenca globale</i> ○ <i>Studime rastesh mbi sfidat e ndërmarrjeve të gjelbërta</i> ○ <i>Strategji për kapërcimin e sfidave dhe zhvillimin e bizneseve të gjelbërta.</i>
Java e katërbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi i planeve të biznesit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.</i> • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale. • Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.	